

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJISE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org.Jedinitca Org Unit	01B
Nr.i faqeve Br.stranica No. pages	2
Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No:	2179
Data: Datum: Date:	29.06.2014
Prishtinë / a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 29 qershor 2015  
Ref. nr. 262/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), nenin 6, paragrafi 1, pika 1.1, 1.7 dhe 1.13 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), si dhe në bazë të kërkesës së Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" (Referencë: 01/1387, 24 qershor 2015), nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa për regjistrimin e studentëve në nivelin e parë të studimeve në vitin akademik 2015/2016 në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".
2. Në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" në vitin akademik 2015/2016, në nivelin e parë të studimeve do të regjistrohen 560 studentë, në programet e akredituara në njësitë akademike, si në vijim:
  - 2.1. Fakulteti i Edukimit, Programi Parashkollor - 100 studentë.
  - 2.2. Fakulteti i Edukimit, Programi Fillor - 100 studentë.
  - 2.3. Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë Shqipe - 80 studentë.
  - 2.4. Fakulteti i Filologjisë, Letërsi Shqipe - 80 studentë.
  - 2.5. Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe letërsi angleze - 100 studentë.
  - 2.6. Fakulteti i Mjekësisë, Infermieri - 70 studentë.
  - 2.7. Fakulteti i Mjekësisë, Mami - 30 studentë.

3. Obligohet Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" të shpall konkursin për regjistrimin e studentëve në nivelin e parë të studimeve në vitin akademik 2015/2016, pas shpalljes së rezultateve të (ri)akreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe në përputhje me vendimet e saj.
4. Obligohet Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe me kërkesën e Rektorit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", (Referencë: 01/1387, 24 qershor 2015), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

### Vendimi ju dërgohet:

1. Rektorit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani";
2. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
3. Departamentit të Arsimit të Lartë, MASHT;
4. Agjencia e Kosovës për Akreditim;
5. Arkivit të MASHT.